



VENDIM

Nr. 128 datë 22.11.2022

**MBI KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË  
DYTË TË STUDIMEVE NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA TË  
UNIVERSITETIT TË TIRANËS  
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 23, pika 4 të ligjit nr 80./2015 dt 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Dekanati i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja mbledhur me datë 21.11.2022, pasi diskutoi propozimet e përcjella nga Njësitë bazë të Fakultetit dhe në mbështetje të nenit 90 të Statutit të Universitetit të Tiranës

VENDOSI

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja kategoritë e mëposhtme:
  - A) studentët që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas VKM-së nr. 403 datë 03.06.2020, ndryshuar me VKM-në nr. 46 datë 27.01.2021, ndryshuar me VKM-në nr. 363 datë 26.05.2022;
  - B) kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj;
  - C) si dhe shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe
2. Për pranimet në ciklin e dytë të studimeve në vitin akademik 2024-2025 kriteret janë si më poshtë:
  - I. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, **Master i Shkencave në:**

**Mësuesi e Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë  
Mësuesi e Gjuhës Frënge për Arsimin e Mesëm të Lartë  
Mësuesi e Gjuhës Gjermane për Arsimin e Mesëm të Lartë  
Mësuesi e Gjuhës Italiane për Arsimin e Mesëm të Lartë  
Mësuesi në Gjuhën Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë  
Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë**



1. Kandidatët që zotërojnë një diplomë në programin e studimit të ciklit të parë, në gjuhën përkatëse, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe/ose në programe të tjera të ciklit të parë, në gjuhën përkatëse, në universitetet publike dhe jopublike, vendase apo të huaja, të akredituara.
2. Kriter pranimi në programet *Master i shkencave në Mësuesi në Gjuhën Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë* është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

**Shënim:** Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.

**II. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, MASTER I SHKENCAVE NË: GJUHË DHE KOMUNIKIM NDËRKULTUROR DHE TURISTIK:**

1. Kandidatët që zotërojnë një diplomë në programin e studimit të ciklit të parë, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe/ose në programe të ngjashme të ciklit të parë, në universitetet publike dhe jopublike, vendase apo të huaja, të akredituara.
2. Kriter pranimi në këtë program studimi "*Master i Shkencave*" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

**Shënim:** Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.

**III. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve  
MASTER I SHKENCAVE NË: MASTER I SHKENCAVE NË PËRKTHIM  
TEKNIK-LETRAR DHE INTERPRETIM**

1. Kandidatët që zotërojnë një diplomë në programin e studimit të ciklit të parë, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe/ose në programe të ngjashme të ciklit të parë, në universitetet publike dhe jopublike, vendase apo të huaja, të akredituara.
2. Kriter pranimi në këtë program studimi "*Master i Shkencave*" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

**Shënim:** Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.



---

**IV. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve,  
MASTER PROFESIONAL NË PËRKTHIM ME PROFIL PËRKTHYES NË  
GJUHË ANGLEZE:**

1. Kandidatët të kenë përfunduar programin e ciklit të parë të studimeve në një universitet të akredituar brenda apo jashtë vendit dhe të njohur nga MASR-ja.
2. Kriter pranimi në këtë program studimi "*Master i Shkencave*" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

**Shënim:** Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.

**DEKAN**

**Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA**

